

Kerko

E Premte, 23 Mars 2012

KREU	Politike	Aktualitet	Ekonomi	Opinion	Rajon	Reportazh	Sociale	Interviste	Kulture	Nderkombetare	Showbiz	Koha Tjeter	Sport
------	----------	------------	---------	---------	-------	-----------	---------	------------	---------	---------------	---------	-------------	-------



Live & Work in USA!



Desar Sulejmani: “Dodona”, gjuha e muzikes se art te Aleksander Pecit

Izaura Ndoj

Kompozitori me i suksesshem shqiptar me fame boterore Aleksander Peci, pas 28 vitesh do te sjelle ne skenen shqiptare nje veper me permasa madhore. “Dodona”, eshte vepra simbolike qe vjen ne kuader te 100-vjetorit te Pavaresise. Ne nje interviste per “Koha Jone” dirigjenti dhe pianisti me fame boterore, po ne te njejten kohe edhe dirigjenti i muzikes se Aleksander Pecit, Desar Sulejmani, rrefen bashkepunimin me kompozitorin si dhe pritshmerite te ketij rikthimi. Pas gati tre dekadash, ai eshte i pari qe sjell ne skenen koreografike shqiptare nje veper te tille serioze me karakter kombetar. Vepra do te realizohet ne skenen e Pallatit te Kongreseve, me rastin e 100-vjetorit te Pavaresise se Shqiperise. Vete kompozitori Peci e vlereson faktin qe pas 28 vjeteve, qe nga koha e baletit “Gjergj Elez Alia” te Feim Ibrahimit, vjen nje premiere e rendesishme absolute baleti shqiptar. Per ta sjelle sa me autoktone kompozitori ka bashkepunuar me disa nga artistet me te mire shqiptare te njohur nderkombetarisht dhe artiste te huaj, po ashtu te suksesshem. Vepra do te interpretohet nga Orkestra e Teatrit Kombetar te Operes dhe Baletit, drejtuar nga dirigjenti dhe pianisti shqiptar, qe punon ne Gjermani, Desar Sulejmani. Me trupen shqiptare te baletit dhe korin e TKOB do te punojne edhe Bernd Schindowski, nje nga koreografet gjermane me te njohur ne bote. Regjisor i shfaqjes eshte Pali Kuke, ndersa djali i tij, Ergin Kuke, permes studios se vendosur ne Hollyeood, do te realizojne skenografin e dhe kostumografin.

Ne kuader te 100-vjetorit te Pavaresise kompozitori Aleksander Peci do te vendos ne skenen shqiptare baletin “Dodona”. Si lindi ideja e ketij bashkepunimi?

Muziken e Aleksander Pecit e njoh prej kohesh, sepse ka qene gjithmone pjese e repertorit tim qofte pianistik, qofte edhe atij orkestral dhe gjithmone e ne aktivitetet e ndryshme brenda dhe jashte Shqiperise e kam luajtur me shume deshire. Une, ne prill te vitit 2011 gjithashtu pata nje koncert pianistik me vepra te reja te kompozitoreve shqiptare, ku muzika pianistike e A. Pecit kishte vendin kryesor. Pas ketij koncerti kemi biseduar gjere dhe gjate per idene e nje baleti kombetar jo vetem sepse kete vit kemi te bejme me 100 vjetorin e shpalljes se Pavaresise se shtetit shqiptar, por per me tepër per shkak te nevojës se domosdoshme per te sjelle ne skenen shqiptare nje balet te ri pas me shume se 25 vjetesh. Une e shikoj kete shtyese artistike te kompozitorit Peci si nje nevojë te tij te brendshme krijuese, e cila natyrisht qelizen e saj ideore dhe konceptonale e ka padyshim te lidhur nder te tjera edhe me faktin e festimeve solemne te 100 vjetorit te shpalljes se Pavaresise.

Desar, prej disa vitesh keni nisur karrieren artistike ne Gjermani. Si ndiheni?

Jetoj prej me shume se 14 vjetesh ne Gjermani. Si dhe shume shqiptare te tjere qe jetojne, studiojne dhe punojne ne kete vend, ndjehem personalisht shume me fat per kete fakt. Jo



Kosova

FLASH NEWS

19:50 | MISIONI NË KABUL, BERISHA: SHQIPËRIA PËRMBUSH DETYRIMET NDAJ NATO-S

19:50 | MAZHORANCA REFUZON PLANIN E OPOZITËS PËR EMERGJENCËN NË VEND

19:50 | “FËMJËT ME AUTIZËM”, VJEN NJË UDHËRRËFYTES PËR PRINDËRIT

19:49 | JAZZETI: “X-FACTOR ATËRANI” QUBED, DRONËFISANT

Te gjitha lajmet

SONDAZH

Kush eshte shkakuar per shtyrjen e procesit te integrimit?

- Mazhoranca
 Opozita
 Te dyja bashke

Shiko rezultatet



ANALIZA - OPINIONE

Keqkuptimet e Presidentit me kompetencen e tij

Edvin KulluriAshtu sic pritej prej kohesh, Presidenti Topi muajt e fundit te mandatit po i konsumon kryesisht si politikan aktiv dhe jo si President ne detyre. E paralajmëruar nga ish-partia e tij, kjo sjellje nuk habit kend, pervec skeptikeve te pakte qe retoriken e PD-se ndaj tij e konsideronin si kaprico ndaj “djalit plangrishes” dhe vetem kaq. Me gjuhen e tij retorike dhe lakonike ne kufijte e nevojës per...

Etika e dinjitetit dhe dinjiteti i nje gjykatesi te perdorur
Spartak BrahoShume kohe pas nje vendimi te dhene nga kolegji



NY Times CNN BBC FT (Europe)

[Irish Inquiry Faults Bertie Ahern and Finds Corruption](#)

Fri, 23 Mar 2012 05:50:06 GMT

[European Union Plans Retaliation in Public Contract Bidding](#)

Thu, 22 Mar 2012 18:30:18 GMT

[Eat: Who Doesn't Love Boerenjongens?](#)

Fri, 23 Mar 2012 05:50:06 GMT

VENDI RAJONI BOTA



Ambasadori Amerikan ne Tirane Aleksander Arvizu dhe kryebashkiaku Lutizim Basha, duke dale sot, nga lokal prane ish bllokut. Ky takim vjen pak dite pas vizites qe kryebashkiaku Basha kreu ne SHBA.

vetem se kam mundur te shkollohem e edukohem gjate ne Gjermani, apo ngaqe kemi te bejme me nje vend, ku kushtet e jeteses jane me te mira sesa ne Shqiperi. Te ndjerit me fat qe jetoj ne Gjermani ka me shume te beje me gjithcka te mire qe une kam mundur te perjetoj, te mesoj, te vrojtoj, te bej per vete gjate periudhes se qendrimit tim ketu ne Gjermani. Me zemren e nje shqiptari te vertete dhe me mendjen e llogjiken e ftohte dhe largpames te nje gjermani besoj se kam gjetur personalisht nje bashkim ideal te dy kulturave ne thelb te ndryshme, qe per mua ama tani jane padyshim te pandashme nga njera-tjetra.

Si e pritert oferten qe Prof. Peci ju beri per te dirizhuar nje veper shqiptare?

Shume mire dhe me gezimin e nje profesionisti idealist qe padyshim zemren e ka gjithmone per pune te mira me Shqiperine. Keshtu e kam pritert dhe do te pres cdo oferte tjetert per te prezantuar gjithmone muziken shqiptare, qofte si pianist, qofte si dirigjent.

Keni hasur veshtiresi ne partiturat qe keni marre per te realizuar kete kryeveper kombetare?

Absolutisht jo. Duhet qe te kemi parasysh qe A. Peci me baletin "Dodona" deshiron te sjelle ne skene nje veper kombetare, ku secili nga ne te marre impulsin dhe ndjenjen personale te te shijuarit dhe perjetuarit te muzikes. Ne kete kuader, kompozitori ka bere nje balance ndermjet gjuhës moderne te te kompozuarit sot me muziken popullore, melosin dhe formen muzikore te baletit. Fakti qe mjaft elemente popullore si p.sh. gjinia e kabase me klarineta do te silltet tek "Dodona" si pjese intergrale e muzikes se tij, flet per nje bashkim te natyrshe me te rese dhe tradicionales ne muziken e ketij baleti. Partitura e "Dodones" eshte nje partiture e qarte per mua dhe cdo dirigjent tjetert qe do ta shikonte, sepse ne kete rast A. Peci deshiron te komunikojte gjeresisht me publikun me muziken e tij, jo vetem per ata te cilet per shkak te formimit te tyre muzikor mund ta kuptonin dhe shijonin ate.

Per ta sjelle sa me autoktone kompozitori ka bashkepunuar me disa nga artistet me te mire shqiptare te njohur nderkombetarisht dhe artiste te huaj, po ashtu te suksesshem...?

Se bashku me kompozitorin Peci kemi rene dakord qe ne fillim te bisedimeve tona, qe koreografin e ketij baleti t'ia besojme nje koreografi nga Gjermania. Ishte insistimi im personal qe te ftonim per te qene pjese e grupit tone artistik koreografin gjerman te mirenjohur nderkombetarisht Bernd Schindowski, i cili pasi i njoh me libretin e "Dodones" dhe idete tona per ta sjelle ate ne skene, menjehere pranoi te ishte pjese e grupit te punes per kete balet. Gjithashtu kam informacion qe A. Peci eshte ne kontakt me Ergin Kuke qe jeton ne SHBA, i cili do te marre persiper kostumografin si dhe regjine skenike per kete balet. Cdo detaj tjetert i kesaj natyre do te mund te behet i njohur per median dhe publikun, kur cdo gje te jete e saktuesuar dhe miratuar ne projekt.

Vepra do te interpretohet nga Orkestra e Teatrit Kombetar te Operes dhe Baletit, drejtuar nga ju. Eshte bashkepunimi juaj i pare me orkestren e TKOB-it?

Ne kete rast dua te theksoj se ne e kemi parashikuar ne projektin tone qe i vetmi institucion qe jo vetem mund ta mbaje nga ana infrastrukture kete projekt, por edhe duhet ta kete si qellim te tijin ne kuader te mbeshtetjes se kultures shqiptare eshte TKOB ne Tirane. E mendojme kete gje jo vetem si deshire dhe mundesi tonen, por mbi te gjitha si nje domosdoshmeri te padiskutueshme te ketij institucioni kulturor kombetar per te sjelle ne skene vepra te reja skenike nga pena e kompozitoreve bashkekohore shqiptare. Une kam informacionin qe projekti i "Dodones" eshte derguar ne komitetin nderministror per festimet e 100 vjetorit te shpalljes se Pavaresise si dhe i eshte derguar TKOB-it per miratim. Per mua do te jete hera e pare qe do te bashkepunoj me orkestren e TKOB, pas kater bashkepunimesh mjaft te mira me orkestren simfonike te RTSH. Me kete rast do te mbyllja edhe rrethin e punes me te gjitha orkestrat shqiptare

penal i Gjykates se Larte per ceshtjen e stisur te nje video-montazhi, qe angazhoi jo vetem politiken, por edhe organet me te larta te drejtesise, njeri nga anetaret e trupit gjykues ka filluar te jape intervista ne media, pasi ka votuar me vullnetin e tij te lire ne favor te pafajesise se zotit I. Meta. Ky paskoment i vendimit te Gjykates se Larte me detyron te...

Tre PD-te e Rames dhe PD e Berishes

Nga Edvin KulluriGjetja me e re e kryetarit te opozites per te dobësuar mazhorancën, eshte konstatim i tij se Aleanca Kuq e Zi dhe partia e prishme e drejtuar nga presidenti Topi, po pervijohen si perfaqesuese te dy "PD-ve" te reja. E thene ndryshe, keto dy parti apo levizje, t'i quajme si te duam, do te perfaqesojne dhe kulminin e "krizes" se te djathtes ose dizintegrimin e saj, me pasojte humbjen e zgjedhjeve duke thithur...

KOHA JONE RSS

Politike	▶
Aktualitet	▶
Opinion	▶
Ekonomi	▶
Rajon	▶
Reportazh	▶
Sociale	▶
Dossier	▶
Kulture	▶
Nderkombetare	▶
Sport	▶



Myftiu i Kosovës, Naim Tërnavë, priti sot zëvendëskryeministrin e Turqisë, Bulent Arınc, i cili po qëndron në Kosovë në shënimin e përvjetorit të 622 të vdekjes së Sulltan Muratit. Në bisedë me Arınc, Myftiu Tërnavë ka kërkuar mbështetjen e qeverisë turke



ministri britanik, David Cameron, tha se 16 mijë policët shtesë që janë vendosur në Londër për të penguar protestuesit, do të mbeten në rrugë gjatë gjithë fundjavës. Autoritetet kanë raportuar për vdekjen e një personi 68-vjeçar - i cili ishte sulmuar të

Program Kontabiliteti

Kontabiliteti Inventari Financa Listepagesa Prodhimi Imp/Exp etj
www.bilanc.com

Automjete Furgona Kamiona

Kerkon apo shet ? shiko ketu i kemi E vetmja faqe qe pasurohet cdo dite
www.shitblerie.info

Kosovo & Serbia Standoff

EU, Kosovo are watching referendum in northern Kosovo
www.SFTimes.com

Google oglasi

POLITIKE

Dita e Demokracise, 100 mijë shqiptare ne shesh
Berisha: Permysem diktaturen, do te kryejme anetaresimin ne BE
Ndoka: Do rishikojme koalicionin me PS
PDIU: Ikonomu, pazar me vizat e BE

EKONOMI

Bankat vazhdojne te "korrin" fitime, shtohen depozitat
INSTAT: Ne 2011-n u prodhua 47.4% me pak energji se me pare
TAP i dorezon Italise vleresimin per mjedisin
Shkelja e konkurrences, biznesi po shton ankesat

SOCIALE

Komisioni i bashkise vendos: Xhamia, te sheshi i Namazgjase Demshperblimi, ulet me 10 vjet moshë e perfituesve
Abetarja shqiptarokosovare, detajet se si do te jete
Maturantet: Altarteksti na ngateron per veprat qe duhet te lexojme

RAJON

AKTUALITET

Permytjet ne Shkoder, Mali i Zi: T'i ndalim se bashku
Nje dite i zhdukur, gjendet i mbytur ne kanal
Per nje cope toke, vret te bijen, plagos vellane
Korrigjohen gabimet ne listat e ish te denuarve politike

OPINION

Keqkuptimet e Presidentit me kompetencen e tij
Etika e dinjitetit dhe dinjiteti i nje gjykatesi te perdorur
Tre PD-te e Rames dhe PD e Berishes
Lot kurvi

REPORTAZH

Identifikohet flamuri me te cilin u varros Ismail Qemali
Riviera shqiptare, mrekullia qe te befason ne cdo hap
Shpirti binjak shqiptar ne Porto?
Bari, si u keqtrajtuau shqiptaret me 1991

NDERKOMBETARE

Joakim Gauk zgjidhet presidenti i Gjermanise
Nje ushtar amerikan vret 15 civile ne Afganistan
Karte Blu, per te huajt me kualifikim te larte

ekzistuese qofte ne Shqiperi, qofte ne Kosove. Bashkepunimin e pritshem me orkestren e TKOB e pres me nje kuriozitet te natyrshem profesional, ashtu sic do te prisja cdo here te pare te punes me nje orkester tjeter.

Cilat jane pritshmerit tuaj per kete balet?

Une pres qe baleti "Dodona" te zere nje vend te merituar ne gjinine e baletit shqiptar. Nese ky projekt do te realizohet me te vertete ashtu sic ne duam dhe kemi menduar, jam i bindur qe publiku shqiptar dhe me vone edhe publiku i huaj do mund te shijoje nje veper mjaft te arrire shqiptare, e cila padyshim do kete vendin e saj te merituar ne listen jo shume te gjate te baleteve te kompozitoreve shqiptare.

Cilat jane projektet qe do t'iu ndjekin ne vazhdim?

Ne fakt per momentin ndodhem per nje turne koncertesh si pianist ne Kine dhe Japoni. Pas kthimit ne Gjermani ne fund te kesaj jave, do te udhetoj drejt Uzbekistanit e me pas drejt Holandes, Shqiperise, e Kosoves, per t'ia lene me pas kohen dhe vendin perseri Gjermanise. Ne fakt jeta ime artistike eshte vazhdimisht ne levizje. Jo vetem per vendndodhjen e koncerteve apo angazhimeve te mia artistike, por edhe per vete faktin e nje levizje dhe zhvillimi te brendshem artistik, i cili eshte edhe forca ime kryesore per te ecur gjithmone perpara.

[Komentet e juaja](#)

Komento Artikullin

Emri

Email

Koment

Submit

Kush jemiNa kontaktoniReklamoni me neTermtat dhe kushtet e perdorimitRuajtja e fshehtesiseArshive

© 1991 - 2010 Koha Jone - Te gjitha te drejtat e rezervuara Programing © WebPhotoPro

Thaci: 4 vitet e pavaresise, hapa konkret drejt BE Presidenti serb, deklarata politike ne Kosove "Kosova, me afer politikave ekonomike te BE" Kriza sprovon fort sistemin e pensioneve ne Greqi

KULTURE

Desar Sulejmani: "Dodona", gjuha e muzikes se art te Aleksander Pecit Robert Ndrejka: Ne rolin e "Doktor Shuster" do te fus veten time "Eja te duhemi", embelsia e vargjeve te gruas ne Teatrin Metropol Ardian Isufi: "Objekt i pidentifikueshem", ceshnja e bashkejteses se besimit

SHOW BIZ

Alketa Vejsiu: Vera thote: "Ky format eshte shpikur per ty!" Harbohen femrat shqiptare ne ditet e tyre! "X Factor Albania", show mbreselenes ne teatrin "Klan" Nata latine ndez skenen tek "Kenget e Shekullit"

Liga Arabe kerkon shtyrje te misionit ne Siri

KOHA TJETER

Eliza Hoxha: Pasioni im eshte fotografia Si te mposhtni lodhjen dhe te riktheni energjite e munguara Tuna hedh poshte cdo "akuze" se dashuron femrat Amy Winehouse, ne vend te duartroitjeve merr fishkellima ne Beograd

SPORT

Tirana merr kryesimin, Skenderbeu nuk ndalet Gjyqtari me "njolle" i heq fitoren Shqiperise Ish-tekniku Josip Kuzhe:"Une ne trukime? Eshte per te qeshur..." Ndricohet "Dinamo", Basha: Celi siparin e investimeve

INTERVISTA

Nexhmije Hoxha: Ju rrefej luften, monizmin dhe 2 dekada demokraci Nexhmije Hoxha: Ju rrefej luftën, monizmin dhe 2 dekada demokraci Basha: Brenda 2015, Bulevardi nga stacioni i trenit tek lumi i Tiranes Blendi Fevziu: "Ditari i nje lideri politik, ne githe boten publikohet"